



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data

RELACION PËR PROJEKTVENDIMIN “RREGULLAT PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË VENDIT PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT”.

Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Migrantëve e vitit 1990, (e cila është nënshkruar dhe nga Shqipëria), u njeh migrantëve të drejtën e pjesëmarrjes në votime në shtetin e tyre të origjinës, ashtu siç parashikon detyrimin e shtetit të origjinës që t’u krijojë atyre mundësinë për të ushtruar të drejtën e votës.

Këto të drejta nga legjislacioni shqiptar në 15 vitet e fundit janë tentuar të realizohen. Në ligjin Nr. 9668 , datë **18.12.2006** për Emigrimin, në neni 6 parashikohet:

- 1.Emigrantët shqiptarë gëzojnë të drejtat dhe liritë politike të parashikuara nga legjislacioni shqiptar, si dhe të drejtën për të marrë pjesë aktive në jetën politike të vendit.
- 2.Autoritetet përgjegjëse krijojnë lehtësirat e nevojshme në mënyrë që emigrantët të ushtrorjnë të drejtën e votës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Legjislacioni në fuqi deri në ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor u jepte emigrantëve të drejtën për të votuar vetëm brenda territorit të Shqipërisë.

Përgjithësisht, votimi jashtë vendit konsiderohet një proces i vështirë dhe sfidues. Ky proces duhet të përmbush standardet e njëjta sikurse votimi brenda vendit, në kuptim të fshehtësisë së votes, barazia së votes, integritetit dhe të transparencës së rezultateve, lirisë së votës, besimit të publikut etj.

Shqipëria hyn në ato shtete, të cilat nuk kanë ende një kornizë të plotë, që rregullon dhe mundëson të drejtën e votimit nga jashtë vendit për zgjedhësit me vendbanim jashtë shtetit.

Ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor (neni 24 dhe 25) mundësuan të drejtën për të votuar nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin, për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Kodi cakton KQZ-në të udhëheq dhe mbikëqyr procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë vendit në të gjithë komponentët e tij. Në këtë kuptim KQZ-së i duhet të rregullojë me akte normative një sërë çështjes, nisur që nga përfaqësimi politik që do të ketë kjo kategori zgjedhësish (duke qenë se Kodi Zgjedhor nuk e ka zgjidhur ngelet vetëm përfaqësimi nëpërmjet kandidatëve të zonës zgjedhore (qarkut) ku këta shtetas kanë brenda vendit regjistrimin në RKGJC), hartimi i listës së



zgjedhëve, mënyra e vitimit, vlerësimi i votave dhe përfshirja e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zonës zgjedhore etj.

Numri i shtetasve shqiptarë që janë me banim të përhershëm jashtë vendit është relativisht i lartë. Ende nuk ka një shifër zyrtare (nga fakti që ende nuk është bërë regjistrimi i tyre) por nga llogaritje të përafërta gjendja në katër zgjedhjet e fundit është pasqyruar në tabelën më poshtë.

Viti	Popullsia			Zgjedhës	
	e regjistruar	rezidente	supozuar jashtë shtetit	te regjistruar	supozuar jashtë shtetit
2009	4,249,942	2,927,519	1,322,423	3,084,946	947,857
2013	4,312,210	2,895,092	1,417,118	3,271,885	1,071,615
2017	4,426,963	2,873,457	1,553,506	3,452,324	1,211,028
2021	4,544,977	2,850,475	1,694,502	3,606,955	1,355,080
	nga DPGJC	nga INSTAT		nga KQZ	

Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor parashikojnë, në nenin 24, kushtet që duhet të plotësojnë shtetasit shqiptar për të votuar nga jashtë: 1) të kenë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit, dhe 2) të kërkojnë nga KQZ-ja që të pajisen me dokumentacionin e votimit nga jashtë.

Procedurat për regjistrimin në RKGJC të adresës janë përcaktuar me ligjin 14/2016 “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të zbatim të tij. Në këto akte është përcaktuar që adresa e emigrantin nuk regjistrohet në Regjistrin përkatës pa u bërë verifikimi i identitetit të tij. Kur procesi bëhet para nëpunësit publik, qoftë në zgjedhje qoftë në konsullat, identifikimi bëhet me prezencën e personit paisur me dokumentin e identifikimit. Kur procesi bëhet on line, verifikimi i identitetit, pasi ka aplikuar elektronikisht në shërbimin përkatës, bëhet nëpërmjet shërbimit postar në adresën që ka deklaruar emigranti.

Nga të dhënat që kemi kërkuar e marrë nga DPGJC-së del që deri tani kanë regjistruar adresën në Regjistrin përkatës, pjesë e RKGJC-së, rreth 32 mijë shtetas me banim jashtë vendit.

Në projektvendimin e paraqitur janë përshkruar rregullat teknike, afate dhe veprime të tjera për regjistrimin e kësaj kategorie zgjedhësish në listën e zgjedhëve që votojnë jashtë vendit. Rregullat teknike janë vendosur në një lidhje pjesë e projektit. Për detajime të mëtejshme

teknike për procesin propozohet të ngarkohet Komisioneri.

Në hartimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit është synuar veçanërisht t'u pritet rruga rasteve të mundëshme të abuzimit, pra që dikush të regjistrojë dikë tjetër me qëllim për të krijuar mundësi t'i përdorë të drejtën e votës me që votimi nuk bëhet në QV me monitorim nga komisionerë e vëzhgues. Ky synim, prerja e rrugës së abuzimit do të përforcohet edhe në fazën e procesit të votimit që do të paraqitet në një akt tjetër.

Edhe për kohën e shkurtër që është në dispozicion, është menduar që kërkesa për regjistrim të bëhet nëpërmjet një sistemi teknologjik on line. Sistemi do të jetë i aksesueshëm në web në formën e një aplikacioni të shkarkueshëm edhe në smartphone.

Shtetasit që do shprehin vullnetin për të votuar nga jashtë vendit siç përcaktohet në nenin 24 të Kodit Zgjedhor, nuk do të mund të regjistrohen në listën e zgjedhësve pa plotësuar dhe konditën tjetër të nevojshme, atë të regjistrimit të adresës së vendbanimit të tij në vendin ku është rezidentë në përputhje me parashikimet e ligjit 14/2016 përmendur më lartë.

Për të verifikuar që personi që po regjistrohet nuk është një person tjetër, sistemi do t'i kerkojë votuesit të identifikohet me një nga dy mënyrat e paraqitura.

Sistemi do të analizojë të dhënat e marra nga procesi i regjistrimit nëpërmjet "përplasjes"/krahasimit me bazat e të dhënave shtetërore si Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, që është një regjistër i konsoliduar e që përmban të gjithë përbërësit zgjedhor të shtetasve e regjistra të tjerë që mund të ndihmojnë në verifikimin dhe saktësimin e të dhënave.

Në projektakt janë vendosur dhe afatet e për realizimin e fazave të procesit të hartimit të listës së kësaj kategorie zgjedhësish.

Për zgjedhjet e këtij viti afati i fillimit të procesit të regjistrimit, me që lidhet me ngritjen e sistemit, i është lënë ta vendos Komisioneri, afati i përfundimit të procesit të regjistrimit është harmonizuar me afatin e nenit 56 të KZ, jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve.

Lista e zgjedhësve do të miratohet nga Komisioneri Zgjedhjeve jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve për t'i lënë kohë DPGJC-së t'i heqë ata nga lista e zgjedhësve të qendrave të votimit ku ata kanë të regjistruar vendbanimin në Shqipëri jo më vonë se 45 ditë para datës së zgjedhjeve. Ky afat mundëson zbatimin e afatit të nenit 56 që ZGJC-të e bashkive të kenë hartuar listat e zgjedhësve për çdo zonë qendrore votimi dhe t'u kenë paraqitur për miratim



kryetarëve të bashkive jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve.

Është menduar që subjektet zgjedhore të regjistruara në KQZ, në se e kërkojnë, t’u jepet pa pagesë nga KQZ një kopje elektronike të listave të zgjedhësve nga jashtë vendit. Kjo listë mendohet të përmbajë disa nga përbërësit zgjedhorë si emër, atësi, mbiemër e datëindje që janë të njëjtë me ato që përcakton neni 46 i Kodi Zgjedhor për publikimin e listave pranë QV-ve, qarkun ku zgjedhësit kanë të regjistruar vendbanimin në Shqipëri në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile si dhe shtetin ku ata kanë regjistruar vendbanimin në “Programin e regjistrimit të adresës”, pjesë përbërëse e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 2021

Nr:

PROJEKTVENDIM
PËR
RREGULLAT PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË VENDIT PËR
ZGJEDHJET E KUVENDIT

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës ____ .2021, me pjesëmarrjen e:

Illirjana NANO	Kryetar
Arens ÇELA	Anëtar
Dritan ÇAKA	Anëtar
Helga VUKAJ	Anëtar
Muharrem ÇAKAJ	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Rregullat për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit për Zgjedhjet e Kuvendit.

BAZA LIGJORE: Neni 20, paragrafi 1, shkronja “dh”, neni 24, neni 25, neni 46, paragrafi 3, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Rregullator, në mbështetje të nenit 20, paragrafi 1, shkronja “dh”, nenit 24, nenit 25, nenit 46, paragrafi 3, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtoi dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

V Ë R E N:

Referuar nenit 20, paragrafi 1, shkronja “dh”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator (Rregullatori) shqyrton dhe miraton projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së për rregullat për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit, për zgjedhjet e Kuvendit.

Referuar nenit 24 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KQZ-ja udhëheq dhe mbikëqyr procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin, për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit dhe kërkojnë nga KQZ-ja që të pajisen me dokumentacionin e votimit nga jashtë. Votimi nga jashtë vendit organizohet dhe administrohet nga KQZ-ja në të gjithë komponentët e tij, pasi Rregullatori të ketë miratuar të gjitha aktet nënligjore që kërkojnë për votimin nga jashtë vendit, sipas Kodit Zgjedhor.

Referuar nenit 46, paragrafi 3, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit përfshin vetëm zgjedhësit me vendbanim jashtë vendit, të cilët deklarojnë vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit, sipas rregullave të dala në zbatim të nenit 24 të Kodit Zgjedhor.

Për përmbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga dispozitat sipërcituar, administrata e KQZ ka përgatitur projekt aktin për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Zgjedhjet e Kuvendit.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Rregullator, mbështetur në nenin 20, paragrafi 2, shkronja “c”, nenin 24, nenin 25, nenin 46, paragrafi 3, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,



V E N D O S I

- 1) Të miratojë rregullat procedurale/teknike për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit për Zgjedhjet e Kuvendit sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Ngarkohet Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për detajime të mëtejshme teknike për procesin e regjistrimit të kësaj kategorie zgjedhësish.
- 2) Sistemi qendror në KQZ për nevojat e funksionimit të tij sipas lidhje 1 të këtij vendimi të komunikojë nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit me Bazat e të dhënave shtetërore si Regjistri i Kombëtar i Gjendjes Civile, Regjistrimi i adresës së banimit të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit etj, me qëllim identifikimin e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 3) Sistemi qendror në KQZ duhet të lejoje auditimin e tij përpara nisjes së procesit zgjedhor, nga auditë expertë të jashtëm, duke analizuar të dhënat e konfiguruar në sistem dhe lojet/gjurmët e veprimeve në të.
- 4) Afati i fillimit të procesit të regjistrimit të zgjedhësve nga jashtë vendit si rregull i përgjithshëm të jetë jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së dekretit të Presidentit për datën e zgjedhjeve për Kuvendin dhe të përfundojë jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve. Përgjithësisht për Zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 prill 2021 afati i fillimit të këtij procesi të vendoset nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në varësi të procesit të prokurimit dhe të përfundojë jo më vonë se 24 shkurt 2021.
- 5) Lista e zgjedhësve nga jashtë vendit e hartuar sipas proceseve të përshkruar në lidhjen e këtij vendimi miratohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve dhe i dërgohet DPGJC-së.
- 6) DPGJC jo më vonë se 45 ditë para datës së zgjedhjeve heq zgjedhësit nga jashtë vendit nga lista e zgjedhësve të qendrave të votimit ku ata kanë të regjistruar vendbanimin në Shqipëri në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
- 7) Subjektet zgjedhore të regjistruara në KQZ, me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, mund të marrin nga KQZ një kopje elektronike të listave të zgjedhësve nga jashtë vendit. Kjo listë përmban përbërësit zgjedhorë të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d” të pikës 1 të nenit 45 të Kodi Zgjedhor, qarkun ku zgjedhësit kanë të regjistruar vendbanimin në Shqipëri në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile si dhe shtetin ku ata kanë regjistruar vendbanimin në “Programin e regjistrimit të adresës”, pjesë përbërëse e Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
- 8) Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

9) Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO **Kryetar**

Arens ÇELA **Anëtar**

Dritan ÇAKA **Anëtar**

Helga VUKAJ **Anëtar**

Muharrem ÇAKAJ **Anëtar**



RREGULLAT PËR REGJISTRIMIN E ZGJDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

- 1) Ne KQZ do te ngrihet një sistem teknologjik on line për regjistrimin dhe administrimin e kërkesave nga shtetasit shqiptare me vendbanim te përhershëm jashtë territorit te RSH të cilët kërkojnë për te votuar ne zgjedhjet për Kuvend 2021, nga ku ata kanë vendbanimin e tyre, jashtë territorit të RSH.
- 2) Sistemi do të jetë i aksesueshëm në web në formën e një aplikacioni të shkarkueshëm edhe në smartphone. Nga këtu e vijim ky sistemi do të përmendet “sistemi”.
- 3) Regjistrimi si votues nëpërmjet sistemit bëhet sipas procedurave dhe kushteve të përshkruar në këtë lidhje.
- 4) Shtetasi që kërkon të votojë jashtë territorit të RSH duhet të ketë deklaruar dhe regjistruar paraprakisht adresën e vendbanimit të tij në përputhje me parashikimet e ligjit 14/2016 “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” dhe akteve nën ligjore të nxjerra në zbatim të tij.
- 5) Shtetasi shqiptar me banim jashtë territorit të RSH dhe që kërkon të votojë duhet të plotësojë të gjitha të dhënat/ fushat që i kërkon sistemi:
 - a) Numrin personal
 - b) Emër, atësi, mbiemër, datëlindje,
 - c) Foto të dokumentit të letërnjoftimit ose të pasaportës të lëshuar nga RSH;
 - d) Foto të dokumentit të identitetit të lëshuar nga shteti ku ka vendbanimin, ose leje qëndrimi në shtetin përkatës;
 - e) Adresën e vendbanimit jashtë RSH;
 - f) Adrese e-mail aktive;
 - g) Numër telefonit celular aktiv;
 - h) Një dokument që tregon lidhje me shtetin ku jeton si kontrate qiraje shtëpie ose dokument pronësie, kontrate me ujësjellës/energjigaz, kontrate punësimi, kontrate shkollimi, etj.
- 6) Sistemi duhet t’i kërkojë zgjedhësit/ aplikantit nëse ai/ ajo ka bërë regjistrimin e adresës së vendbanimit të përhershëm jashtë vendit në “Programin e regjistrimit të adresës”, pjesë përbërëse e Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile.
- 7) Nëse përzgjidhet “Jo”, do te njoftohet me një mesazh paralajmërues për detyrimin që ka shtetasi te aplikojë pranë shërbimit ne DPGJC për te regjistruar vendbanimin e tij duke i ofruar linkun përkatës dhe se aplikimi i tij nuk do te vazhdoj te përpunohet pa kryer këtë regjistrim.

- 8) Nëse përzgjidhet “Po” dhe të dhënat e tjera/përbërësit zgjedhor të tij/saj janë të sakta sistemi e informon se ai/ajo është kandidat për t’u përfshirë në listën e zgjedhësve që banojnë jashtë vendit.
- 8.1 Në se përzgjidhet “po” dhe të dhënat e tjera/përbërësit zgjedhor të tij/saj nuk janë të sakta sistemi e informon se duhet t’i plotësojë dhe deri sa t’i saktësojë nuk do vazhdojë procedurën më tej.
9. Për të verifikuar që personi i cili po regjistrohet nuk është një person tjetër, sistemi duhet ti kërkojë votuesit të plotësojë fushat e sistemit me të dhëna me një nga dy mënyrat:

Mënyra 1:

Aplikuesi duhet të plotësoj të dhënat që kanë të bëjnë me:

atësia, mëmësia, vendlindja e tij, vendlindja e babait, vendlindja e nënës, datëlindja e babait, datëlindja e nënës, emri i vëllezërve dhe/ose motrave, datëlindjet e tyre, emrat e fëmijëve të regjistruar ne DPGJC, datëlindjet e fëmijëve, vendlindjet e fëmijëve, datëlindja e bashkëshortes/bashkëshortit, vendlindja e bashkëshortes/bashkëshortit.

Mënyra 2:

Votuesit duhet t’i kërkohe të instalojë në smartphone e tij një aplikacion i cili do të përdoret për të automatizuar procesin e identifikimit të tij nëpërmjet teknologjive “Face ID”. Aplikacioni do të kryejë krahasimin e pamjes së tij (foto selfie) me foton në dokumentin e identifikimit. Aplikacioni do të jetë i aftë të dallojë që personi në fjalë është i vërtetë dhe jo një foto (liveness identification). Aplikacioni do të verifikojë pamjen e shtetasit sa here që ai e përdor atë. Në rast se shtetasi nuk ka një smartphone të aftë të mbajë aplikacionin, atij do ti ofrohet mundësia ta kryejë të njëjtën procedure duke u lidhur me një faqe web (pjesë e sistemit qendror) nëpërmjet një kompjuteri me kamera.

- 10) Sistemi qendror do të analizoje të dhënat e marra nga procesi i regjistrimit për të verifikuar saktësinë e tyre duke komunikuar me bazat e të dhënave shtetërore si Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, Regjistri i adresave të shtetasve shqiptare që jetojnë jashtë vendit apo regjistra të tjerë që mund të ndihmojnë në verifikimin dhe saktësimin e të dhënave.
- 11) Nëse këto të dhëna përputhen, sistemi finalizon regjistrimin në listën e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit. Me këtë rast sistemi i dërgon me e-mail në kontaktet e deklaruara linku-n personal/unik dhe të dhënat e duhura unike që i japin mundësi të marre pjesë në votim. Në këtë mënyrë është hapur edhe “llogaria” personale në sistem për aplikuesin.
- 12) Nëse këto të dhëna nuk përputhen sistemi do të njoftojë automatikisht shtetasin për rezultatet e mospërputhshmërisë/mos regjistrimin e tij.